

Kërkesat e hyrjes për Covid-19

- për austriakët,
- shtetasit e BE-ZEE-së,
- zviceranët,
- personat me banim apo qëndrim të përkohshëm në Austri,
- personat me leje qëndrimi, të drejtë banimi sipas NAG ose AsylG 2005, vizë D ose letërnjoftim sipas § 95 FPG

(Për personat me banim apo qëndrim të përkohshëm në Austri që janë jashtë territorit federal në 24 korrik, situata juridike përpara hyrjes në fuqi vlen deri në afatin e skadimit më 29 korrik.)

1. Hyrja nga shtete të sigurta

Hyrja pa kufizime mund të kryhet vetëm nga një prej shteteve të sigurta (shtojca A1 e urdhrit për hyrjen në Austri) (nga data: 13.08.2020):

Për një listë të përditësuar të shteteve të sigurta, shihni: www.bmeia.gv.at

Kushti është që personi të ketë qenë në një prej këtyre shteteve në 10 ditët e fundit!

Nëse personi ka qenë **dhe në shtete të tjera brenda 10 ditëve të fundit**, hyrja është e mundur sipas kushteve të mëposhtme:

- Personi paraqet një certifikatë mjekësore në hyrje, e cila konfirmon **testin negativ PCR** (Me rëndësi: Konfirmimi nuk duhet të jetë më i vjetër se 72 orë).
- Nëse personi nuk mund të paraqesë test negativ PCR në hyrje, duhet të kalojë **10 ditë në karantinë (shtëpie)** dhe duhet të paraqesë një **konfirmim të akomodimit** (si dhe t'i përballojë vetë shpenzimet). Personi mund ta përmbyllë karantinën (e shtëpisë) nëse kryen një test PCR gjatë procesit dhe rezultati është negativ (testin PCR duhet ta paguajë vetë).

2. Hyrja nga shtete me rrezik

Në rast **hyrjeje nga një prej shteteve ku ka një rrezik të shtuar në lidhje me COVID-19** (shtojca A2 e urdhrit për hyrjen në Austri), është **e nevojshme të paraqitet një certifikatë shëndetësore** (Nga data: 13.08.2020):

Për një listë të përditësuar të shteteve për të cilat është lëshuar paralajmërim për udhëtimin, shihni: www.bmeia.gv.at/reise-aufenthalt/reisewarnungen

Parakusht për hyrjen nga shtetet me rrezik

- Personi paraqet një certifikatë mjekësore në hyrje, e cila konfirmon **testin negativ PCR** (Me rëndësi: Konfirmimi nuk duhet të jetë më i vjetër se 72 orë).
- Nëse personi nuk mund të paraqesë test negativ PCR në hyrje, duhet të kalojë **në karantinë (shtëpie)** nga hyrja dhe duhet të paraqesë një konfirmim të detyruar të akomodimit (si dhe t'i përballojë vetë shpenzimet). Pas hyrjes **personi duhet të kryejë brenda 48 orëve një test PCR** (dhe ta paguajë vetë). Nëse rezultati i testit është negativ, karantina mund të përmbillet.

3. Hyrja nga të gjitha vendet e tjera

Për **hyrje të drejtpërdrejtë nga të gjitha vendet e tjera** (d.m.th. vende që nuk përmenden në shtojcën A1 apo A2 të urdhrit për hyrjen në Austri), hyrja mund të kryhet vetëm me një **certifikatë mjekësore apo me nisjen e një karantine (shtëpie) 10-ditore**.

Parakusht për hyrjen nga të gjitha shtetet e tjera

- Personi paraqet një certifikatë mjekësore në hyrje, e cila konfirmon **testin negativ PCR** (Me rëndësi: Konfirmimi nuk duhet të jetë më i vjetër se 72 orë).
- Nëse personi nuk mund të paraqesë test negativ PCR në hyrje, duhet të kalojë në karantinë (shtëpie) nga hyrja. Personi mund ta përmbyllë **karantinën (e shtëpisë)** nëse kryen test PCR gjatë procesit dhe rezultati është negativ (testin PCR duhet ta paguajë vetë).